

MNN Qendrore

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

5 shkurt 2025

Rajoni i Mesoamerikës



Kuba

Historia e Kubës është një histori e rënies së popullsisë Indigjene pas ardhjes së Kristofor Kolombit në vitin 1492, zhvillimi i saj më pas si një koloni Spanjolle gjatë shekujve të ardhshëm dhe sjellja e një numri të madh skllëvërish Afrikanë për të punuar në plantacionet e kafesë dhe sheqerit. Ndërhyrja e SHBA-së gjatë Luftës Spanjolle-Amerikane në vitin 1898 ndihmoi Kubën të shpëtonte nga sundimi Spanjoll. Nën udhëheqjen e Fidel Kastros, revolucionari Kuban zgjati më shumë se pesë vjet, duke krijuar një sistem politik socialist në vitin 1959. Kushtetuesisht, një shtet socialist Marksist-Leninist, Kuba ka një sistem një-partiak. Një nga vendet më të varfra në Hemisferën Perëndimore, paga mesatare në Kubë është midis 20-40 \$ Amerikanë në muaj, shumë më poshtë kufirit ndërkombëtar të varfërisë prej pak më shumë se 60 \$ Amerikanë në muaj, që jep pamjen e një niveli të varfërisë prej gati 66%. Zyrtarisht, Triumfi i Revolucionit (Dita e Çlirimit), 1 Janar 1959, konsiderohet pavarësia e Kubës nga sundimi i huaj. Kisha e Nazaretasit filloi punën në Kubë në vitin 1902, duke e bërë atë një nga veprat më të vjetra në denominacion.



9,507 Anëtarë



144 Kisha plotësisht të
organizuara; 3 Kisha
ende jo të organizuara



22 Shërbyes Distriktual
të Liçencuar dhe 76
Shërbyes të Shuguruar
në 3 Distrikte

LUTJE



- Lutuni për pastorët dhe familjet e tyre në Kubë, të cilët shërbejnë me besnikëri për të ndarë Lajmin e Mirë të Jezusit.
- Lutuni për përpjekjet për të siguruar pushime për këto familje dhe për të forcuar lidhjet e miqësisë së shërbesës anembanë Kubës.

LAVDËRIM



- Lavdëroni Perëndinë për suksesin e të mbledhurit së bashku të këtyre familjeve për restaurimin e shpirttrave dhe përtëritjen e thirrjes për të shërbyer në rrethana sfiduese.
- Lavdëroni Perëndinë për ata që po i përgjigjen thirrjes së Perëndisë për jetën e tyre për të shërbyer në Kubë, dhe për ata që kanë filluar të studiojnë zyrtarisht për shërbesë.



Kaleidoskopi për Fëmijë

Click [here](#) to access Kids Kaleidoscope, a monthly addition to NMI Central to awaken and nurture a spirit of missions in everyone.

Një Shikim i Shpejtë MNN



Pushimi dhe përtëritja: Një tërheqje transformuese për familjet e pastorëve në Kubë



Në zemër të Kubës, diçka e jashtëzakonshme po ndodh. Familjet e pastorëve, të cilët shpesh mbajnë peshën e shërbesës në rrethana sfiduese, kanë përjetuar një mundësi të rrallë dhe shumë të nevojshme për pushim, rinovim dhe lidhje familjare. Falë Nazaretasve që kanë kontribuar në këtë projekt, këto familje po mblidhen së bashku për një përvojë unike të tërheqjes, e krijuar për të rifreskuar shpirtat e tyre dhe për të forcuar lidhjet e tyre.

Për shumë familje pastorale në Kubë, koha për pushim dhe rikrijim është e pakët. Kërkesat e shërbesës dhe sfidat e jetës së përditshme mund ta bëjnë të vështirë që ata të shkëputen dhe të përqendrohen në kohën me familjen. Duke e njohur këtë nevojë, Ministria e Zhvillimit të Fëmijëve dhe Sponsorizimi i Fëmijëve të Pastorëve nisën një projekt të veçantë— pushimesh që u ofrojnë këtyre familjeve hapësirë për t'u rilidhur, rimbushur dhe rritur së bashku.



Deri tani, dy distrikte kanë organizuar me sukses retreat-e, ndërsa një i tretë është gati. Rezultatet kanë qenë asgjë më pak se të jashtëzakonshme. Një pastor Kuban, Yendri, ndau përvojën e tij personale, duke thënë se pavarësisht vështirësive të vazhdueshme ekonomike, retreat-i ishte një "dhuratë e vërtetë nga Zoti". Për Yendrin dhe familjen e tij, koha e kaluar së bashku dhe me familjet e tjera pastorale, ishte si një thesar i paçmueshëm, duke u ofruar atyre një ndjenjë pasurie që i kapërceu sfidat e tyre financiare.

Retreat-et kanë qenë më shumë se thjesht një pushim nga rutina - ato kanë qenë transformuese. Pastorët dhe familjet e tyre janë kthyer në shtëpi emocionalisht dhe shpirtërisht të fuqizuar, me energji të përtërirë për shërbesë. Këto retreat-e janë bërë një burim uniteti, duke ndihmuar familjet të forcohen në marrëdhënie dhe besimin e tyre.

Pavarësisht sfidave logjistike të dërgimit të fondeve në Kubë, këto retreat-e kanë vazhduar të ecin përpara, falë përpjekjeve të partnerëve të përkushtuar dhe hirit të Zotit. Dëshmitë e atyre që kanë marrë pjesë flasin për ndikimin e thellë që kanë pasur këto përvoja, duke sjellë shërim, shpresë dhe rinovim për familjet që shërbejnë pa u lodhur në komunitetet e tyre.

Ky projekt është vetëm një shembull se si Kisha e Nazaretasit po plotëson nevojat unike të Nazaretasve në mbarë botën. Ajo shërben si një kujtesë se edhe në rrethanat më të vështira, besimi, lidhja dhe fuqia e Krishtit mund të sjellin ndryshime të jashtëzakonshme.

Ndërkohë që përgatitjet për retreat-in e tretë kanë filluar, entuziazmi dhe pritshmëria vazhdojnë të rriten. Këto retreat-e kanë dëshmuar se janë një mjet shpëtimi për familjet pastorale dhe ndikimi i tyre i qëndrueshëm tashmë po ndihet në të gjithë Kubën.

A mund të shërbeni?

A po ju thërret Zoti që të merrni pjesë në misionin e Tij?
Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT